



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KRYEMINISTRI

URDHËR

Nr. 137, datë 13.09.2018

PËR

NGRITJEN E GRUPIT NDËRINSTITUCIONAL TË PUNËS PËR ZBATIMIN E MASËS 15 TË PLANIT TË VEPRIMIT TË STRATEGJISË KOMBËTARE PËR DIASPORËN

Në mbështetje të pikës 3, të nenit 102, të Kushtetutës, të pikës 1, të nenit 12, të ligjit nr.9000, datë 30.1.2003, "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave", të vendimit nr.259, datë 9.5.2018, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Diasporën 2018-2024 dhe të planit të veprimit".

URDHËROJ:

1. Ngritjen e grupit ndërinstitucional të punës për zbatimin e masës 15 të planit të veprimit të Strategjisë Kombëtare për Diasporën, miratuar me vendimin nr.259, datë 9.5.2018, të Këshillit të Ministrave.
2. Grupi ndërinstitucional i punës të përbëhet nga:
 - Drejtori i Përgjithshëm i INSTAT –it kryetar;
 - përfaqësuesi i ministrit përgjegjës për diasporën anëtar;
 - zëvendësministri në ministrinë përgjegjëse për punët e jashtme anëtar;
 - zëvendësministri në ministrinë përgjegjëse për arsimin anëtar;
 - titullari i Agjencisë Kombëtare për Diasporën anëtar.
3. Instituti i Statistikave, në përputhje me masën 15 të planit të veprimit të Strategjisë Kombëtare për Diasporën, miratuar me vendimin nr.259, datë 9.5.2018, të Këshillit të Ministrave, në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse të përcaktuara në këtë urdhër, të hartojë raportin vjetor statistikor për diasporën shqiptare, ku të pasqyrohen të dhënat dhe vlerësimi i shteteve ku duhet vepruar me përparësi nga politikat për diasporën,



4. Struktura e raportit vjetor të INSTAT-it për diasporën shqiptare të realizohet në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare për Diasporën.
5. Ngarkohen Ministri i Shtetit për Diasporën, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, Instituti i Statistikave (INSTAT) dhe Agjencia Kombëtare për Diasporën për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E M I N I S T R I

EDI RAMA

